

## **Njoftim mbi aplikimin e shoqërisë “GREENSOL” shpk**

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, në vijim të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 158, datë 05.06.2026 dhe nr. 179, datë 29.06.2026, njoftojmë se shoqëria “GREENSOL” shpk ka përditësuar projektin e centralit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “GREENSOL” shpk, me kapacitet të instaluar 49.96 MW, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bisticë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë, duke përfshirë tanimë dhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve (nga data 01.07.2026 deri më 30.07.2026), pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al).